



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 10.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.12.2020 të parashtruar nga OE "Vlera SHPK", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore"** me Nr. të Prok: **616-20-3417-221** dhe numër te brendshëm: **616 20 099 221** nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE "Vlera" Shpk të dt.07.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore"**, me Nr. të Prok: **616-20-3417-221** dhe numër te brendshëm **616 20 099 221**.
2. Autoriteti Kontraktues vendos te vazhdoj aktivitetin sipas Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të publikuar me datë: **03/12/2020**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE "Vlera " Shpk me datë 07.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore "**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 10.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:


- Lidhur me pretendimin tuaj se Autoriteti Kontraktues eshte dashte t'iu kerkoj sqarime sikurse tenderuesit tjeter eshte i pa bazuar pasiqe ne vleresimet,sqarimet dhe Vendimet paraprake eshte vertetuar se dokumenti per te cilin eshte refuzuar tenderi juaj eshte dokument ne te cilin kini nderhyre dhe nuk eshte dokument origjinal i prodhuesit.Pra per diçka qe eshte verifikuar me pare nuk ka arsye te kerkohet sqarim,ndersa per tenderuesin tjeter eshte kerkuar sqarimi nga prodhuesi,pasi qe me pare ka deklaruar se dy dokumentet jane te tij.

-Bazuar ne kete ju sqarojme se pretendimet tuaja jane te pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit